



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 16, dt. 08.01.2016

Në mbështetje të nenit 47 të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e dates 08.01.2016, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit për ndërtimin e “Uzina për prodhimin e ferrokromit me karbon të lartë”, Suç, Burrel, me investitor shoqërinë “ASCCr” sh.p.k.
2. Projekti të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Këshillin Kombëtar të Arkeologjisë.
3. Shoqëria të kontribuojë për restaurimin dhe konsolidimin e çatisë së kullës së Sul Lëkurësit, në fshatin Gurrë e Madhe, Mat, sipas projekt-preventivit të hartuar nga specialistët e DRKK-së Shkodër.
4. Gjatë procesit të zbatimit për ndërtimin e uzinës për prodhimin e ferrokromit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikqyren sipas nenit 48 të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI